VENDIM
Nr.444, datë 1.5.2008

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2008, MIRATUAR PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE PËR KURIMIN E VONIS POKA, NË TURQI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në Buxhetin e miratuar për vitin 2008, zëri "Shpenzime operative", t'i shtohet fondi 1 800 000 (një milion e tetëqind mijë) lekë, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve për kurimin e fëmijës Vonis Poka, në Turqi.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
3. Pagesa të bëhet kundrejt paraqitjes së faturave origjinale të institucionit të kurimit.
4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi nr.689, datë 19.10.2007 i Këshillit të Ministrave "Për një shtesë fondi në Buxhetin e vitit 2007, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve për kurimin e Vonis Poka, në Turqi", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha